

VENDIM
Nr. 95, datë 4.2.2015

**PËR PROCEDURAT PËR VLERËSIMIN E KËRCËNIMIT TË RREZIKUT PËR
JETËN DHE PAJISJEN ME AUTORIZIM TË POSAÇËM PËR MBAJTJE ARME¹**

(Ndryshuar me VKM nr. 728, datë 12.12.2018; nr. 289, datë 19.5.2021)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 30, pika 2, të ligjit nr. 74/2014, datë 10.7.2014, "Për armët", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Policia e Shtetit ka përgjegjësinë për vlerësimin e kërcënimit të rrezikut për jetën për persona që, për shkak të aktivitetit shtetëror ose të rrethanave personale të veçanta, janë të ekspozuar ndaj rrezikut për jetën dhe u njihet e drejta e mbrojtjes së veçantë.

2. Vlerësimi i rrezikut për jetën dhe lëshimi i autorizimit përkatës për mbajtje arme bëhet për dy kategori personash:

- a) Persona në rrezik për shkak të aktivitetit shtetëror;
- b) Persona në rrezik për shkak të rrethanave personale të veçanta.

3. Policia e Shtetit të krijojë komision për vlerësimin e rrezikut të personave, për shkak të aktivitetit shtetëror që kanë pasur ose kanë aktualisht, si dhe për shkak të rrethanave personale të veçanta, me këtë përbërje:

- a) Drejtor i Departamentit për Sigurinë Publike *kryetar;*
- b) Drejtor i Drejtorisë Kundër Krimeve ndaj Personit dhe Pasurisë *anëtar;*
- c) Drejtor i Drejtorisë së Rendit Publik *anëtar;*
- ç) Shef i sektorit të ndihmës juridike *anëtar;*
- d) Shef i sektorit të shërbimeve të të tretëve *anëtar.*

4. Për vlerësimin e kërcënimit për jetën, brenda 72 orëve nga paraqitja e kërkesës, të administrohet dokumentacioni, si më poshtë vijon:

a) Kërkesa e personit, që kërcënohet për shkak të aktivitetit shtetëror ose rrethanave personale të veçanta për pajisjen me autorizim të posaçëm për mbajtje arme, e cila bëhet online, në portalin unik qeveritar e-Albania dhe dubet të përmbajë:

- gjenealogjetet e plota të personit (emër, atësi, mbiemër, datëlindje);
- adresën e banimit;
- numrin e kontaktit;
- arsyen për të cilën kërkon të pajiset me autorizim të posaçëm;

b) Relacion nga komisarati ku banon personi, lidhur me ekzistencën e kërcënimit të jetës së personit, që kryen apo ka kryer më parë aktivitet shtetëror, ose të rrethanave personale të veçanta;

c) Ekstrakte nga informacionet, materiale të dala nga hetimi, materiale të dala nga kryerja e operacioneve apo teknikave speciale të hetimit etj., që i disponon policia ose institucione të tjera shtetërore, për ekzistencën e kërcënimit ose rrezikut të jetës së personit që ka bërë kërkesën;

ç) Kopje e dokumentit identifikues të personit të kërcënuar;

¹ VKM nr. 95, datë 4.2.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 16, datë 12 shkurt 2015.

VKM nr. 728, datë 12.12.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 176, datë 13 dhjetor 2018.

d) Vërtetim besueshmërie për personin e kërcënuar, hartuar nga komisariati ku ka vendbanimin.

4/1 Në zbatim të ligjit nr. 74/2014, "Për armët", të ndryshuar, personi, përveç dokumenteve të dorëzuara online, duhet të kryejë paraprakisht procedurat përkatëse për të siguruar dhe dorëzuar fizikisht dhe origjinale në komisariatet e policisë ku ka vendbanimin, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga momenti i plotësimit online të kërkesës, edhe dokumentet e mëposhtme:

- raportin mjeko-ligjor lëshuar nga autoriteti përkatës, brenda 6 muajve të fundit, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike;

- dëshminë e aftësisë teorik-praktik për përdorimin e armës.

5. Këto dokumente, të administruara në komisariatet e policisë, brenda 5 (pesë) ditëve pune, dërgohen për t'u regjistruar në drejtorinë vendore të policisë, e cila, pasi bën vlerësimin dhe shpreh mendimin mbi dokumentacionin e dërguar nga komisariati i policisë, e përcjell atë për shqyrtim në Komisionin Qendror në Policinë e Shtetit.

6. Rrethana personale të veçanta konsiderohen ato kur, për shkak të detyrës, rrethanave të rastit ose flagrancës, personi ka dijeni për kryerjen e veprës penale, është lehtësisht i identifikueshëm nga autorët e veprës penale dhe për këtë shkak i rrezikohet jeta.

7. Komisioni shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga drejtoria vendore/rajonale e policisë ku ka vendbanimin personi i kërcënuar për shkak të aktivitetit shtetëror ose rrethanave personale të veçanta dhe merr vendim për lëshimin e autorizimit brenda 10 (dhjetë) ditëve nga paraqitja e kërkesës.

8. Komisioni merr vendim paraprak, me shumicë, për vlerësimin e rrezikut dhe për lëshimin e autorizimit për mbajtje arme, me qëllim ruajtjen e jetës.

9. Autorizimin për mbajtjen e armës e firmos drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, brenda 24 orëve nga vendimmarrja e komisionit.

10. Shfuqizohet.

11. Afati i vlefshmërisë së autorizimit të posaçëm për mbajtje arme bazohet në vlerësimin e ekzistencës së kërcënimit dhe rrezikut për jetën, vlerësim i cili kryhet të paktën çdo 1 (një) vit.

11/1 3 (tre) muaj përpara përfundimit të afatit të autorizimit të posaçëm, shtetasi ka të drejtë të paraqesë kërkesë për rivlerësimin e ekzistencës së kërcënimit dhe rrezikut për jetën, me qëllim rinovimin e autorizimit. Për rinovimin e autorizimit shtetasi duhet të ndjekë të njëjtat procedura, si në rastin e pajisjes me autorizim të posaçëm, për herë të parë.

11/2 Në rast se Komisioni nuk vendos për rinovimin e autorizimit të posaçëm, në zbatim të nenit 42, të ligjit nr. 74/2014, "Për armët", të ndryshuar, personit i pushon vetiu e drejta për mbajtjen e armës dhe detyrohet që, brenda 3 (tri) ditëve, ta dorëzojë në organin përgjegjës të Policisë së Shtetit që ka për detyrë administrimin e armës.

Pas dorëzimit të armës në organin përgjegjës të Policisë së Shtetit, që ka për detyrë administrimin e armës, personi ka të drejtë:

a) të ndjekë procedurën për tjetërsimin (shitjen) e armës sipas nenit 39, të ligjit nr. 74/2014, "Për armët", të ndryshuar;

b) të kërkojë autorizim për mbajtje arme në vendbanim. Në këtë rast ndiqen procedurat, rregullat dhe afatet për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve, për pajisjen me autorizim, për mbajtje arme në vendbanim.

12. Pas lëshimit të autorizimit për mbajtje arme, për rastet e rrezikut për shkak të aktivitetit shtetëror apo për shkak të rrethanave të veçanta, dokumentacioni, së bashku me vendimet e komisionit dhe kopjen e autorizimit, regjistrohet në një regjistër të veçantë dhe mbahet në kartotekë.

13. Për dokumentacionin, kur nuk miratohet lëshimi i autorizimit për mbajtje arme, afati i mbajtjes në kartotekë është 2 (dy) vjet dhe, më pas, asgjësohet, me procesverbal, sipas rregullave të përcaktuara për çdo dokumentacion tjetër.

14. Mbledhjet e komisioneve zhvillohen me protokoll, i cili mbahet së bashku me regjistrin dhe dokumentacionin e shqyrtuar.

15. Dispozitat e këtij vendimi nuk zbatohen për personat të cilëve ligji ua njeh të drejtën për të mbajtur armë.

16. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama